



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 232/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Agon Ramadani – Kryetar, znj. Nita Bejta-Referuese, znj. Kimete Gashi – Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: **OE N.N.P “CTA” sh.p.k -Prishtinë**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i çerdhes në Rufc të ri -Ritenderim”, me nr.prokurimit: 613-22-4220-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-**KK Lipjan**, më datën: 12.08.2022, morri këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: **OE N.N.P “CTA ” sh.p.k -Prishtinë**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i çerdhes në Rufc të ri -Ritenderim”, me nr.prokurimit: 613-22-4220-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-**KK Lipjan**.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i çerdhes në Rufc të ri -Ritenderim”, me nr.prokurimit: 613-22-4220-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-**KK Lipjan** dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: **OE N.N.P “CTA ” sh.p.k -Prishtinë**, i aprovet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: **OE N.N.P “CTA ” sh.p.k -Prishtinë**, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 27.06.2022 me nr. 232/22, kundër njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i çerdhes në Rufc të ri -Ritenderim”, me nr.prokurimit:613-22-4220-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-**KK Lipjan**, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenin 56 dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe
- Nenin 41 të RrUOPP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 30.06.2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt:08.07.2022, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues pretendon se AK ka shkelur Nenin 1 të LPP-së pasi nuk ka shfrytëzuar fondet publike në mënyrë efikase pasi që shpërblen me kontratë OE "ENGROUP" sh.p.k në vlerë 213 309.40 EURO, kurse oferta jonë ishte me çmim më të ulët ashtu siç është kërkuar në DT dhe njoftimin për kontratë. Ndërsa buxheti i shtetit është dëmtuar në vlerë 5.904.42 Euro.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se oferta e operatorit ekonomik ankues është: 207 404.62 Euro, ndërsa oferta e OE të rekomanduar për kontratë është 213 309.04 Euro, me gjithsej dallim në shumë prej 5 904.42 Euro, më i shtrenjtë se sa OE ankues. Andaj duke pas parasysh kriterin e dhënies së kontratës si dhe Nenin 1 të LPP-së, AK-ja do të duhej të vlerësoj tenderët konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

OE ankues thekson se AK-ja ka shkelur nenin 56 të LPP-së, e cila na ka diskualifikuar lidhur me stafin profesional si dhe makinerinë që kemi në 3 projekte një kërkesë e tillë nuk ka qenë e specifikuar në DT dhe njoftimin për kontratë.

AK-ja na ka eliminuar pa asnjë arsye për faktin se arsyeja e eliminimit nga ana e AK-së nuk ka qenë e specifikuar fare në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Në letrën standarde për tenderues OE ankues është eliminuar me arsyetimin se:

Komisioni gjate vlersimit ka verejtur se OE "C.T.A "N.N.P ne Komunen e Lipjanit ka ofertuar ne tri projekte ,prej tyre per dy eshte fitues; "Nderitmi I Qerdhes ne Shalë"afati per kryerje eshte 300.dite dhe "Ndertimi I shkolles ne Ribar te Madh"afati per kryerje eshte 250.dite ,ndersa edhe ne projektin "Nderimi I Qerdhes ne Rufc te Ri eshte me I lire

Komisioni ka verejtur se OE ne fjale ka te njejtin staf dhe te njejta paisje ne tri projektet .

Pasi qe secili projekt e ka afatin per kryerjen e punimeve ne mendojme se ky OE nuk ka mundesi potenciale te I realizon te tri projektet ne te njejten kohe,staf dhe paisje

Eksperti shqyrtues, sqaron se arsyeja e eliminimit të OE ankues është në kundërshtim me Nenin 56.3 të LPP-së, për faktin se një kërkesë e tillë nuk ka qenë e specifikuar në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë. Andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3

OE ankues thekson se AK-ja ka shkelur Nenin 60 të LPP-së sepse si pasojë e mos vlerësimit real të ofertave dhe trajtimit të dëshmimeve sipas kërkesave të dosjes së tenderit na ka eliminuar duke na konsideruar si të pa përgjegjshëm. Kjo përbën shkelje të kriterit që tenderi do ti jepet tenderuesit të përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Eksperti shqyrtues konstaton që në Nenin 30.1 të Dosjes së tenderit si kriter i dhënies së Kontratës është përcaktuar: “Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët**”, andaj AK-ja është dashur të veprojë konform kërkesave të përcaktuara në dosje të tenderit dhe të veprojë në harmoni me nenin 60 të LPP-së. Pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 4

OE ankues thotë se AK-ja ka shkelur nenin 41.11 të RRUOPP, pasi na ka eliminuar pa asnjë arsye, sepse një kërkesë e tillë nuk ka qenë e specifikuar në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë. Arsyeja është sepse stafin profesional si dhe makinerinë që kemi në 3 projekte janë të njëjtë.

Eksperti shqyrtues thekson se edhe në Nenin 41.11 të RRUOPP-së është përcaktuar se: citat *“Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit”*, mbyll citatin. Andaj vlerësoj se arsyeja e eliminimit të OE ankues është në kundërshtim me nenin 41.11 për faktin se një arsyetim i tillë nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Andaj pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE NNP “CTA” Sh.p.k -Prishtinë të aprovohet si e bazuar, dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 08.07.2022 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 13.07.2022, me anë të parashtresës , ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik me datë: 08.07.2022, me anë të parashtresës , ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca e shqyrtimit të ankesës është mbajtur me datën 12.08.2022, pa praninë e palëve, konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, për shkak se nuk është konsideruar e nevojshme që të ftohen palët bazuar në faktin se ka pasur prova dhe argumente të mjaftueshme në shkresat e lëndës, si dhe duke qenë se të gjitha të dhënat në këtë rast kanë qenë të qarta dhe pa nevojë për sqarime shtesë, paneli ka vazhduar me mbajtjen e seancës kryesore si dhe këshillim-votimin në po të njëjtën ditë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

Lidhur me pretendimet e OE ankues, PSH mbështet raportin e ekspertizës dhe mendimet e ekspertit vlerësues ku ankesa aprovohet si e bazuar si dhe vlerëson se arsyetimi i dhënë nga AK, në letrën standarde për eliminimin e OE ankues, AK nuk ka ofruar arsyetim me bazë ligjore dhe nuk i referohet legjislacionit në fuqi.

Për më tepër, arsyetimi i dhënë lidhur me disponueshmërinë e mjeteve si dhe stafit për realizim të këtij aktiviteti nuk është pjesë përbërëse e ndonjë kërkesë apo kriteri dhe nuk specifikohet në dosje të tenderit, andaj konform nenit 41.11 të RRUOPP, Tenderuesi nuk mund të diskualifikohet në këto raste.

Sa i përket shkeljeve të pretenduara tek nenet 1 dhe 60 të LPP-së lidhur me "tenderët e përgjegjshëm me çmimin më të ulët", është mëse evidente se këto dy komponente, i **përgjegjshëm dhe çmimi më i ulët**, kanë lidhshmëri absolute ndërmjet vete në kuptimin që

efekti arrihet vetëm me përmbushjen e këtyre të dyjave, andaj përmbushja e këtyre do të konstatohet pas rivlerësimit nga komisioni vlerësues që ka kompetencën e vendimmarrjes lidhur me këtë çështje, e kjo len të kuptohet që, një ofertë mund të ketë çmimin më të ulët, por fillimisht duhet ta plotësoj kushtin që të jetë e përgjegjshme.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Z. Agon Ramadani

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK “Lipjan”

1x1 OE - N.N.P “CTA ” sh.p.k -Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.